

**REPUBLIKA E SHQIPERSISE**  
**SHOQERIA TREGETARE**  
**"BEALB KONSTRUKSION" SH.P.K.**  
**TIRANE**

**VENDIM NR 06 DATE 30/06/2014**  
**I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE TREGETARE**  
**"BEALB KONSTRUKSION" SH.P.K.**

Ne Tirane, sot ne date 30, muaji Qershor, viti 2014, u mblodh Ortaku i vetem i Shoqerise Tregetare "BEALB KONSTRUKSION" Sh.p.k. Tirane , ne seline e saj mori ne shqyrtimi rendin e dites :

- a) Shqyrtimi i veprimtarise tregetare dhe tregueseve financiare te Shoqerise "BEALB KONSTRUKSION" Sh.p.k. Tirane, si dhe ecuria e saj ne te ardhmen;
- b) Zmadhimin e kapitalit themeltar te Shoqerise Tregetare "BEALB KONSTRUKSION" Sh.p.k. Tirane ;

Ortaku i Vetem ,z. Bujar XHAFERRI, pasi u njoh me rendin e dites

**VEREN SE :**

Shoqeria Tregetare "BEALB KONSTRUKSION" Sh.p.k. Tirane, eshte e rregjistruar prane Qendres Kombetare te Rregjistrimit, date 02.03.2009, me Ortak te vetem z. Bujar XHAFERRI dhe administrator z. Bujar XHAFERRI.

Gjate shqyrtimit te veprimtarise tregetare dhe tregueseve financiare te shoqerise "BEALB KONSTRUKSION" Sh.p.k. Tirane, Ortaku konstaton se per ecurine me te mire te shoqerise ne te ardhmen, per te patur nje vazhdimesi dhe siguri te veprimtarise, te behet zmadhimi i kapitalit aksionar te kesaj shoqerie, ne baze te Statutit, Aktit te Themelimit dhe Ligjit "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare" me rezervat dhe fitimet e pa shperndara, sipas gjendjes se bilancit te dates 31.12.2013.

Per keto arsye,Ortaku i Vetem i Shoqerise Tregetare "BEALB KONSTRUKSION" Sh.p.k. Tirane, z. Bujar XHAFERRI, pas shqyrtimit te rendit te dites :

**VENDOSI :**

- Zmadhimin e kapitalit aksionar te shoqerise tregetare "BEALB KONSTRUKSION" Sh.p.k. Tirane, nepermjet rezervave dhe fitimeve te pashperndara te shoqerise, gjendje me 31.12.2013;
- Caktimin e z. Lavdimir FUSHA, anetar i Insitutit te Eksperteve Kontabel te Regjistruar, me Nr.Licence 97 date 10.01.2001, per vleresimin e zmadhimit te kapitalit aksionar me rezervat dhe fitimet e pa shperndara;
- Depozitimimin e ketij vendimi prane Qendres Kombetare te Rregjistrimit , si dhe Drejtorise Rajonale Tatimore.

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE TREGETARE**  
**"BEALB KONSTRUKSION" SH.P.K TIRANE**

**BUJAR XHAFERRI**

*Bujar Xhaferrri*



**REPUBLIKA E SHQIPERSISE**  
**SHOQERIA TREGETARE**  
**"BEALB KONSTRUKSION" SH.P.K.**  
**TIRANE**

---

**VENDIM NR 07 DATE 15/07/2014**  
**I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE TREGTARE**  
**"BEALB KONSTRUKSION" SHPK**

Në Tirane, sot në datën 15, muaji Korrik, viti 2014, u mbledh Ortaku i Vetëm i Shoqërisë Tregtare "BEALB KONSTRUKSION" SHPK Tirane, në selinë e shoqërisë, për shqyrtimin e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i Raportit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar për vlerësimin e rezervave dhe fitimeve të pashpërndara për zmadhimin e kapitalit aksionar të Shoqërisë, të datës 12 Korrik 2014 të përgatitur nga z. Lavdimir FUSHA, Ekspert Kontabël i Regjistruar;

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, z. Bujar XHAFERRI, pasi u njoh me rendin e ditës;

**V Ë R E N S E**

Shoqëria Tregtare "BEALB KONSTRUKSION" SHPK Tirane, është regjistruar pranë Qendres Kombetare te Regjistrimit me date 02.03.2009.

Ortaku i Vetëm i kësaj shoqërie është z. Bujar XHAFERRI. Kapitali aksionar i kësaj shoqërie është 100,000 (njëqind mijë) Lekë. Kështu, z. Bujar XHAFERRI zotëron 100 % të kapitalit aksionar, i barabartë ky me 100 (njëqind) kuota me vlerën 100,000 (një qind mijë) Lekë, ku secila kuota ka vlerën prej 1,000 (Një mijë) Lekë;

Me Vendimin Nr. 06, datë 30/06/2014, Ortaku i Vetëm i Shoqërisë ka vendosur:

- Zmadhimin e kapitalit aksionar te shoqerise tregtare "BEALB KONSTRUKSION" Sh.p.k. Tirane, nepermjet rezervave dhe fitimeve te pashperndara te shoqerise, gjendje me 31.12.2013;
- Caktimin e z. Lavdimir FUSHA, anetar i Insitutit te Eksperteve Kontabel te Regjistruar, me Nr.Licence 97 date 10.01.2001, per vleresimin e zmadhimit te kapitalit aksionar me rezervat dhe fitimet e pa shperndara;
- Depozitimimin e ketij vendimi prane Qendres Kombetare te Regjistrimit , si dhe Drejtorise Rajonale Tatimore.

Në vështrim të rendit të ditës, Ortaku i Vetëm i kësaj shoqërie, pasi njihet me Raportin e Ekspertit Kontabël të Regjistruar për vlerësimin e rezervave dhe fitimeve të pashpërndara për zmadhimin e kapitalit aksionar të Shoqërisë, të datës 12/07/2014, i përgatitur nga Eksperti Kontabël i Regjistruar z. Lavdimir FUSHA, vëren se ky raport është i drejtë, në përputhje me ligjet në fuqi dhe për këto arsye duhet miratuar.

Sipas këtij raporti, zmadhimi i kapitalit aksionar të shoqërisë bëhet nga 100,000 (njëqind mijë) Lekë në 20,000,000 (Njëzet milion) Lekë, e barabartë kjo me 100 (njëqind) kuota (pjesë)



kapitali, secila me vlerë nominale prej 200,000 (Dyqind mije) Lekë. Pra, vlera nominale e kuotave (pjesëve) të kapitalit aksionar rritet ndersa numri i kuotave (pjesëve) te kapitalit mbetet i pandryshueshëm.

Ky kapital do të zotërohet nga Ortaku i Vetëm në këtë mënyrë:

z. Bujar XHAFERRI, do të jetë përsëri zotërues i 100 % të kuotave të kapitalit aksionar, i cili do të përbëhet nga 100 (njqind) kuota (pjesë) kapitali nga ku secila kuotë (pjesë) do të ketë vlerën nominale prej 200,000 (Dyqind mije) Lekë.

Për këto arsye, Ortaku i Vetëm, pas shqyrtimit të rendit të ditës;

### V E N D O S I

1. Miratimin e Raportit të Ekspertit per vleresimin e rezervave dhe fitimeve te pashperndara per zmadhimin e Kapitalit Aksionar te Shoqerise te dates 12 Korrik 2014 te pergatitur nga z. Lavdimir FUSHA, Ekspert Kontabel i Regjistruar;
2. Zmadhimin e Kapitalit Aksionar te kesaj shoqerie nga 100,000 (njqind mije) Lekë në 20,000,000 (Njzet milion) Lekë , e barabarte kjo me 100 (njqind) kuota (pjesë) kapitali;
3. Vlera nominale e kuotave (pjesëve) të kapitalit aksionar rritet ndersa numri i kuotave (pjesëve) te kapitalit mbetet i pandryshueshëm;
4. Vlera nominale e kuotave (pjesëve) të kapitalit aksionar rritet nga 1,000 Leke ne 200,000 (Dyqind mije) Lekë,
5. **z. Bujar XHAFERRI**, do te jete perseri zoteruese i 100 % te kuotave te kapitalit aksionar, i cili do te perbehet nga 100 (njqind) kuota (pjesë) kapitali ku secila kuote (pjesë) do te kete vleren nominale prej 200,000 (Dyqind mije) Lekë;
6. Depozitimn e këtij vendimi pranë Qendres Kombetare te Regjistrimit .

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE TREGETARE  
"BEALB KONSTRUKSION" SH.P.K TIRANE**

**BUJAR XHAFERRI**

*Bujar Xhaferrri*

